

# EUROPA

DREJTOR: ENO TRIMÇEV • KRYEREDAKTOR: GJERGJI VURMO • SHEFE E MARREDHENIEVE ME JASHTË: SABINA YMERI

## Integrimi i Shqipërisë merr mbështetje popullore në '06



**OLLI REHN  
PERSHENDET  
MARREVESHJEN  
E RE TREGTARE  
ME SHQIPERINE**

FAQE 9

**M**bështetja e shqiptarëve për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian është përmirësuar ndjeshëm në vitin 2006 me rreth 8% më shumë sesa në vitin 2005 (kur mbështetja shënonte 83.9%). Ky fakt bëhet publik nga një sondazh i Institutit të Studimeve Ndërkombëtare (AIIS) me pesë kategori të anketuarish – administratën qendrore dhe atë vendore, biznesin, OJQ-të dhe Media – në dhjetë qytetet më të mëdha të vendit. Sipas studimit, ndërkohë që nënshkrimi i MSA duket se ka ndikuar në rritjen e mbështetjes për anëtarësim nga këto grupe, të anketuarit prapëseprapë nuk janë mjaft optimistë për afatin kohor në të cilin vendi do të anëtarësohet në BE. Gjetjet më të fundit të sondazhit të katërt vjetor të AIIS i cili synon të identifikojë perceptimet dhe njohuritë e shqiptarëve në lidhje me Bashkimin Europian dhe procesin e integrimit europian në vend, janë prezantuar të martën (21 Nëntor 2006) në konferencën e përvitshme të Institutit “Shqipëria dhe BE – Perceptime dhe Realitete”. Pjesëmarrësve në konferencë - përfaqësues të institucioneve, politikanë, institucione kërkimore (think tank), mediat, rrethet akademike, biznesi, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar dhe të përfaqësive të huaja diplomatike në Shqipëri – u janë drejtuar Ministrja e Integrimit Europian Znj. Arenca Trashani, Kryetari i Komisionit Parlamentar për Integrimin Z. Ilir Meta, si edhe përfaqësues të Institutit të Studimeve Ndërkombëtare, Z. Albert Rakipi, Z. Eno Trimçev dhe Znj. Sabina Ymeri. Në fjalën e saj Ministrja Trashani prezantoi përpjekjet e Shqipërisë në rrugën e saj drejt BE dhe theksoi nevojën e informimit mbi procesin e integrimit europian.

FAQE 8

**GJETJET  
KRYESORE TË  
STUDIMIT TË AIIS**

**Në këtë numër:**

**Komisioni lehtëson informacionin mbi Politikën Agrare**

FAQE 2

**Greqia kërcënon me veton e Bashkimin Evropian**

FAQE 6

**Zgjerimi i BE në Ballkan, Strategjia e moratoriumit?**

FAQE 7

**Politikat e BE**

FAQE 14

**EU INTERESANTE**

FAQE 15